

Family ID Number: _____ Participant Name(s): _____

Të drejtat dhe përgjegjësitë e WIC

Duam të sigurohemi që i kuptoni të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësit të WIC. Të drejtat dhe përgjegjësitë e WIC vlejné gjithashtu nëse merrni ndihma nga WIC Farmers' Market Nutrition Program (Programi i Ushqimit i Tregut të Fermerëve të WIC) (FMNP). Të drejtat dhe përgjegjësitë e FMNP përfshijnë por nuk janë të kufizuara në trajtimin me respekt dhe mirësjellje nga shitësit e FMNP, dhe përdorimin e kontrolleve të tregut të fermerëve sipas udhëzimeve nga stafi i WIC.

Të drejtat e mia

- **Ushqimet e WIC:** Nëse kualifikohem për WIC, do të marr një kartelë të eWIC për blerje të ushqimeve të shëndetshme. WIC ofron disa, por jo të gjitha ushqimet/formulat për të cilat secili pjesëmarrës ka nevojë.
- **Të dhënat ushqyese:** Do të marr informacione lidhur me të ngrënit shëndetshëm dhe jetesën aktive.
- **Mbështetja për gjidhënie:** WIC do të më ndihmojë dhe mbështesë për gjidhënie.
- **Të dhënat për kujdesin shëndetësor:** Unë do të marr informacione lidhur me imunizimet, gjetjen e kujdesit shëndetësor dhe shërbime të tjera për të cilat mund të jem i interesuar.
- **Trajtimi i drejtë:** Rregullat e qasjes në WIC janë të njëjta për të gjithë. Mund të kërkoj dëgjim të drejtë nëse dikush më thotë se nuk mund të jem në WIC dhe unë nuk pajtohem.
- **Mirësjellja e zakonshme: Stafi i WIC dhe i dyqanit do të më trajtojë me mirësjellje dhe respekt. Mund t'i tregoj stafit të WIC se nuk jam trajtuar me respekt.**
- **Informacionet e transferimit:** Unë mund të transferoj WIC tim në një klinik ose në një shtet tjetër. Mund të kërkoj letër transferimin.
- **Programi i ushqyerjes i WIC nuk diskriminon:**

Në përputhje me ligjin federal për të drejtat civile dhe rregulloret e politikave të drejtave civile të Departamentit të Bujqësisë së SHBA-së (USDA), këtij institucioni i ndalohet të diskriminojë në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, seksit (duke përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual), paafësisë, moshës, ose hakmarrja ose hakmarrja për veprimtari të mëparshme të të drejtave civile.

Informacioni i programit mund të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera përveç anglishtes. Personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë mjete alternative të komunikimit për të marrë informacionin e programit (p.sh. Braille, printim të madh, audio, Gjuha Amerikane e Shenjave), duhet të kontaktojnë Shtetin përgjegjës ose Agjencinë lokale që administron programin ose Qendrën TARGET të USDA në (202)-720-2600 (zë dhe makina teleshtypesh) ose kontaktoni USDA përmes Shërbimit Federal të Transmetimit në (800)-877-8339.

Për të paraqitur një ankesë për diskriminimin të programit, një Ankues duhet të plotësojë një Formular AD-3027, Formulari i Ankesës i Programit USDA për Diskriminimin i cili mund të merret në internet në: <https://www.fns.usda.gov/sites/default/files/resource-files/ad3027-albanian.pdf> nga çdo zyrë USDA, duke telefonuar (866)-632-9992, ose duke shkruar një letër drejtuar USDA. Letra duhet të përmbajë emrin, adresën, numrin e telefonit të ankuesit dhe një përshkrim me shkrim të veprimit diskriminues të pretenduar në detaje të mjaftueshme për të informuar Ndihmës Sekretarin për të Drejtat Civile (ASCR) për natyrën dhe datën e një shkeljeje të pretenduar të të drejtave civile. Formulari ose letra e plotësuar AD-3027 duhet të dorëzohet në:

- (1) **Posta:**
U.S. Department of Agriculture
Office of the Assistant Secretary for Civil Rights
1400 Independence Avenue, SW
Washington, D.C. 20250-9410; ose
- (2) **Fax:**
(833)-256-1665 or (202)-690-7442; ose
- (3) **Posta elektronike:**
program.intake@usda.gov

Ky institucion është një ofruer i mundësive të barabarta.

Informacionet e ndara

Informacionet tuaja mund të ndahen:

- Me programe të tjera të WIC nëse ju transferoheni.
- **Me programe të tjera publike që mund t'ju ndihmojnë. Ju mund të kërkonti të shihni një listë të këtyre programeve.**
- Siç kërkohet me ligj.

Përgjegjësitë e mia

Pajtohem të jap informacione të vërteta dhe të plota lidhur me:

- Identitetin tim, statusin e shtatëzënisë, statusin e gjdhënies, adresën dhe numrin e telefonit.
- Të hyrat e ekonomisë sime familjare.
- Numri i njerëzve që jetojnë në ekonominë familjare me mua.
- Të qenit në Medicaid, FoodShare (vulat e ushqimit), TANF (Temporary Assistance to Needy Families), ose FDIPIR (Food Distribution Program on Indian Reservations).

Pajtohem t'i respektoj rregullat e mëposhtme. Unë do të:

- Përfitoj vetëm nga një klinikë e WIC secilin muaj.
- Raportoju për kartelën time të humbur ose të vjedhur të eWIC ose WIC pompën e ushqyerjes me gji tek stafi i WIC.
- Sigurohem se cilido person që e caktoj ta përdorë kartelën time të eWIC i di rregullat e WIC. Unë do ta mësoj atë se si ta përdorë kartelën time të eWIC në mënyrën e duhur.
- Respektoj terminet e mia me WIC ose do ta thërras klinikën për termin të ri.
- Përdor ushqime dhe formula të WIC vetëm për personin në WIC dhe sigurohem që ushqimet shkojnë me personin në WIC në rastet e mbajtjes së përbashkët, kujdesit adoptues, etj.
- **Nuk shes, dhuroj ose ofroj kartelën time të eWIC, WIC ushqimet ose formulat, ose pompën e gjirit.** Nëse kam artikuj të WIC që nuk mund t'i përdorë, do t'i kthej ato në klinikë.
- Nuk tregtoj/shkëmbej ose kthej kartelën time të eWIC, WIC ushqimet ose formulat, ose pompën e gjirit për para, kredi, kontrolle të shiut ose artikuj të tjerë.
- **Nuk postoj artikujt të WIC në internet.**
- Ndjekë rregullat në Udhëzimin e Blerjes të WIC.
- Nuk shaj, bërtas, ngacmoj, kërcënoj ose dëmtoj fizikisht stafin e WIC ose të dyqanit.
- Nuk plotësoj transaksionin tim, përveç nëse jam në linjën e kontrollit dalës, nëse jam i/e punësuar nga një dyqan i autorizuar i WIC.

Marrëveshja: Unë duhet të pajtohem me këta artikuj që të jenë në WIC:

- Të gjitha informacionet që i kam dhënë në WIC janë të vërteta. Do ta informoj stafin e WIC menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim.
- WIC mund të verifikojë madhësinë e ekonomisë sime familjare dhe të gjitha burimet e të hyrave për ekonominë time familjare.
- Nëse unë i thyej rregullat e WIC, Unë ose fëmija im mund të largohemi nga WIC.
- Nëse gënjej ose i fshehi faktet për të marrë ushqimet e WIC ose nëse nuk kthej pompën e huazuar të gjirit, unë do të duhet ta paguaj WIC vlerën në para për ato artikuj.
- WIC është program federal i ndihmës. Nëse unë i thyej rregullat e WIC, mund të përballem me ndjekje civile ose penale sipas ligjeve të shtetit federal.

E kam lexuar këtë formular, ose stafi i WIC e ka lexuar atë para meje për mua. Unë i kuptoj dhe pajtohem me rregullat e mësipërme dhe kam pranuar një kopje të drejtave dhe përgjegjësisë në udhëzuesin e blerjeve WIC.

NËNSHKRIMI – Pjesëmarrës/Prind/Kujdestar/Ofrues i kujdesit

Data e nënshkrimit